

STATUTI
SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ONE CONSTRUCTION” SHPK

Sot me date **29/12/2022** ortaket e i shoqerise si me poshte ;

- **Jeton Hoti**, i biri i İdrizit, lindur më **09.06.1984** në Burrel dhe banues në Tiranë, posedues i kartës së identitetit **Nr. 036569065**;

Bazuar ne vullnetin tim te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” i ndryshuar, themeloj shoqerine sa me poshte vijon :

KREU I
OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

NENI 1. OBJEKTI I SHOQERISE

Shoqeria ka kete objekt veprimtari :

1. Studim, Projektim dhe Zbatim objekte te ndertimeve Civile dhe Industriale;
2. Studim, Projektim dhe Zbatim Ura dhe Vepra te Artit;
3. Studim, Projektim dhe Zbatim Rruge Rurale, Urbane dhe Interurbane, Autostrada, Tramvaj, Metro, Pista Aeroportuale;
4. Studim, Projektim dhe Zbatim vepra Monumentale dhe Kulturore;
5. Studim, Projektim dhe Zbatim Arkitektonik;
6. Studim, Projektim dhe Zbatim Arkitekturo - Interior dhe Eksterior;
7. Studim, Projektim Topografik;
8. Studim, Projektim dhe Zbatim Urban dhe Peisazhi;
9. Studim, Projektim dhe Zbatim Impiante te Energjise se Renovueshme;
10. Studim, Projekti dhe Zbatim Shkolla, Qendra Shendetesore, Spitale, Qendra Kulturore, Kinema, Teatro;
11. Studim, Projektim dhe Zbatim Sistemeve Mbrojtese nga Zjarri;
12. Studim, Projektim dhe Zbatim Ndertime Parafabrikat, Beton/Arme, Metalike & Druri;
13. Mbikeqyrje dhe Kolaudim Punimesh te Ndertimit;
14. Shitje/Blerje dhe Vleresim Pasurie te Paluajtshme;
15. Konsulence Inxhinierike dhe Arkitektonike;
16. Prodhim energjie me te gjitha menytrat e mundshme bashkekohore, instalimin dhe lidhjen, shperndarjen.
17. Aktivitet ne fushen e ndertimeve civile, industriale, turistike, bujqesore, etj., kompletimi dhe instalimet e nevojshme per to.
18. Sherbim parkim automjetesh.
19. Blerje dhe shitje e makinave dhe makinerive si nje nder aktivitetet e kompanise.
20. Import - Eksport dhe Blerje-Shitje materiale ndertimore.

21. Transport te materialeve te ndertimit, inerte dheu dhe makineri.
22. Ndertimi i autostradave, rrugeve, aeroporteve dhe objekteve sportive.
23. Vendosja e instalimeve per uje, gaz, ngrohje, ventilacion dhe per ftohje.
24. Grumbullim, transport, ruajtje dhe perpunim i mbetjeve urbane dhe mbetjeve ndertimore te vellimshme. Larje, fshirje, mirembajtje, pastrim i rrugeve dhe trotuareve. Sinjalistika rrugore etj.
25. Ushtrim aktiviteti ndertimor per llogari te saj, sipermarrje e/ose koncensione punesh ndertimore, per shkolla, spitale, ndertime rrugore, autostradash, aeroportesh, ndertimesh hekurudhore, digash, portesh, ndertime urash, tunelesh, punime te bonifikimit, kanalizime ujesjellesa e vepra ne beton arme ne pergjithesi, konstruksione metalike apo te perziera, punime hidraulike, elektrike, te ndricimit rrugor, elektronike, te ngrohjes, te kondicionimit, hidrosanitare, te depuracionit, te dekoracionit ne pergjithesi, te papershkueshmerise, te gjithe ato pune te drejtuara e te lidhura me ndertimin.
26. Punime te inxhinierise ambientale.
27. Menaxhim te sherbimeve publike, si ujesjelles, depuratore (pastrues), shkarkues, ndricim rrugor, varreza etj.

NENI 2. EMERTIMI DHE SELIA JURIDIKE E SHOQERISE

2.1. Shoqeria do te emertohet **“ONE CONSTRUCTION” SHPK.**

2.2. Selia kryesore juridike e Shoqerise ndodhet ne, **Tirane, Rr. Bedri Karapici, Kompleksi Golden Park, Godina I, Kati 1, Hyrja 2.**

2.3. Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.


NENI.3. REGJIMI JURIDIK

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.

3.2. Shoqeria mund te ndryshoje regjimin juridik te saj, n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast do te pershtatet Akti e Themelimit dhe Statuti e shoqerise, si dhe do te behet regjistrimi i saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ne perputhje me ligjin.

3.4. Shoqeria do te kete vulen e saj.



Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

NENI 4. TE DREJTAT E SHOQERISE

- 4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
- 4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
- 4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak apo aksionar ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.
- 4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj. Ajo ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e ortakut dhe as ky i fundit nuk mban pergjegjesi personale per detyrimet qe merr persiper shoqeria.

NENI 5. KOHEZGJATJA

- 5.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar

Kreu III


KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

NENI 6. KAPITALI THEMELATAR

- 6.1. Kapitali themeltar eshte **100.000 (njqind mije) leke**.
- 6.2. Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte :
- **Jeton Hoti, 1 pjese, me vlere 100.000 (njqind mije) leke**, e barazvlefshme me pjesemarrje ne perqindje ne masen **100% (njqind perqind)**.
- 6.3. Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te merren.
- 6.4. Ky kapital nuk mund te jete me i vogel se minimumi i percaktuar me ligj.

NENI 7. TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

- 7.1. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme kundrejt te treteve.
- 7.2. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen, personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e titullarit te shoqerise.



KREU IV

DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE

NENI 8. DREJTIMI

- 8.1. Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.
- 8.2. Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, NIPT-i duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxjerr kjo shoqeri dhe ju drejtohen te treteve.
- 8.3. Organet kryesore te shoqerisa eshte vete personi themelues.

KREU V

ADMINISTRIMI

NENI 9. ADMINISTRATORI

- 9.1. Shoqeria do te administrohet nga 1 (Nje) administrator, i cili percaktohet nga personi themelues
- 9.2. Administrimi i shoqerise do te jete: **Znj.Eranda Koldashi me nr ID: J25804007G**
- 9.3. Kohezgjatja ne detyre e administrator/it/eve te shoqerise do te jete per nje afat 5-vjecar.
- 9.4. Administrator/i/et i kane te gjitha te drejtat e fuqite per drejtimin e zakonshem te shoqerise, me qellim arritjen e objektivave te saj.
- 9.5. Administrator/it/eve i takon firma/nenshkrimi e lire dhe perfaqesimi i shoqerise ndaj te treteve ne veprime, procedura dhe seanca gjyqesore, arbitrazhi ose administrative.
- 9.6. Administrator/i/et jane pergjegjes, sipas rastit, ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo deme te kryera gjate ushtrimit te detyres.
- 9.7. Kompetencat kryesore te administrator/it/eve ne shoqeri jane :
 - kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e ortakeve:
 - perfaqeson shoqerine tregtare.
 - kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
 - pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise.
 - Krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
 - Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit.
 - Kryerjen e te gjitha veprimeve bankare ne interes te shoqerise.

- Te perfaqesoje Shoqerine me te tretet ne te gjithë veprimtarine e saj dhe te mbroje interesat e saj ne gjykate apo arbitrazh, nenshkrimin e kontratave ne emer te shoqerise dhe ndjekjen e zbatimit te tyre.

KREU VI

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE

NENI 10. VITI FINANCIAR

10.1. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare i cili fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit.

10.2. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga ortaket e shoqerise.

10.3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 11- KONTROLLI I SHOQERISE

11.1. Kontrolli i Shoqerise kryhet nga nje Ekspert Kontabel i Autorizuar, i emeruar nga ortaket e shoqerise.

11.2. Eksperti kontabel i autorizuar garanton qe llogarite vjetore te shoqerise jane te rregullta, te hartuara me sinqeritet dhe pasqyrojne rezultatet e vitit te kaluar financiar, si dhe gjendjen financiare te shoqerise. Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondet e shoqerise, kontrollon pershtatjen e kontabilitetit me ligjin ne fuqi, verifikon perputhjen me llogarite vjetore te informacionit te dhe ne raportin e administrimit, kontrollon gjithë librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proces-verbaleve. Mund te aktivizojë eksperte dhe bashkepuntore per te perballuar volumin e punes, por duke marre me pare miratimin e ortakut te vetem.

11.3. Shkarkimi i Ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi nga ana e ortakeve.


KREU VII

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

NENI 12. PRISHJA

12.1. Shoqeria mund te priset ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkaku, si ne rast falimentimi, privim te te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga themeluesi.

12.2. Shoqeria hyn ne fazen e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj.



12.3. Ne fund te procesit te likujdimit, vendoset mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuduesit, dhe mbylljen e procesit te likujdimit.

NENI 13. ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

13.1.Mosmarrveshjet e shoqerise dhe te treteve ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.


Kreu VIII

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 14

14.1.Per sa nuk eshte e parashikuar ne kete Statut, do t'i behet referim ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, si dhe legjislacionit koherent.

14.2.Ky statut hartohet ne 3 (tre) kopje, secila me te njejten vlere ligjore. Njera prej kopjeve ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.



Z. JETON HOTI

Tirane me : 29 / 12 /2022